



| | |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA | |
| QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA | |
| MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH | |
| Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit | 02 |
| Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No. | 05-5128 |
| Nr. i faqëve Br. stranica No. pages | -4- |
| Data: Datum: Date: | 25,09,2019 |
| Prishtinë / a | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Generalnog Sekretara/Office of the Secretary General

Prishtinë,
25.IX.2019

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, nxjerr;

Qarkore Informativ Nr. 04/2019

Për: Të gjitha Institucioneve Shëndetësore.

Qëllimi: Zbatimi i Rregullores së Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës.

Ministria e Shëndetësisë në funksion të zbatimit të Rregullores kërkon nga institucionet shëndetësore si në vijim:

1. Informimin dhe raportimin me shkrim nga gjithë zyrtarët përgjegjës të institucioneve shëndetësore për donacionet e përfituara në formë të granteve, mallrave, shërbimeve apo huave. Informatat duhet dërguar ne Sekretarinë e Grupit Punues Nën-Sektorial – GPNS Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë. (burbuqe.zatriqi@rks-gov.net)
2. Obligon zyrtarët përgjegjës të institucioneve shëndetësore që të dërgojnë të dhënat për donacionet e përfituara nga periudha **01.01.2018 deri më 31.12.2018** dhe nga periudha **01.01.2019 deri me 31.09.2019**. Afati i dorëzimit të të dhënave është **15.10.2019** (burbuqe.zatriqi@rks-gov.net)
3. Obligon zyrtarët përgjegjës të institucioneve shëndetësore që të dërgojnë në vazhdimësi të dhënat për donacionet e përfituara nga periudha **01.10.2019** në baza 3 mujore Afati i dorëzimit të të dhënave është data 15 i muajit pasues të tremujorit. (p.sh. për periudhen tetor – dhjetor, afati i dorëzimit është 15 janar). (burbuqe.zatriqi@rks-gov.net)

4. Obligon zyrtarët përgjegjës të institucioneve shëndetësore që për secilin donacion të përfituar të dërgojnë emrin e zyrtarit përgjegjës apo Projekt Koordinatorit të projektit të financuar nga donatorët në formë të grantit apo ndihmave falas në formë të mallrave

Baza Ligjore:

1. Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është bashkërendimi, programimi dhe harmonizimi i prioritetëve kombëtare për zhvillim me prioritetet për financim nga asistenca e jashtme, si dhe rritjen e efektivitetit dhe transparencës gjatë procesit të koordinimit të aktiviteteve të institucioneve të Republikës së Kosovës me komunitetin e donatorëve të jashtëm në Republikën e Kosovës.

Grupi Punues Nën-Sektorial-Shëndetësia është strukturë për koordinimin e asistencës së donatorëve të jashtëm me karakter operativ dhe teknik, në kuadër të Nën-Sektorit – Shëndetësia, të përcaktuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Përgjegjësi e GPNS-Shëndetësia, është koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve të donatorëve të jashtëm në sektorin e shëndetësisë.

Pjesë e Qarkores është:

Aneksi 1 - Tabelat për plotësimin e të dhënave mbi donacionet e pranuar



Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh

Qarkorja u dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit
- Bordit të SHSKUK-së
- Të gjitha institucioneve shëndetësore
- Drejtorëve të Departamenteve të Ministrisë së Shëndetësisë
- Departamentit Ligjor
- Arkivit

| Donatori | Emërtimi | Sasia | Cmimi për njësi | Total | Institucioni | Zyrtar përgjegjës/Projekt koordinator |
|----------|----------|-------|-----------------|-------|--------------|---------------------------------------|
| | | | | | | |
| | | | | 0.00 | | |